

MBËSHTETJA TEK ALLAHU

Hoxhë
Lulzim Perçuku

Titulli: *“Mbështetja tek Allahu”*

Ligjëroi: Hoxhë Lulzim Perçuku

Kontrolloi: Hoxhë Lulzim Perçuku

Transkriptoi: Albiona Olluri

Kopertina&Faqsja: Rajan Alliu

Nëntor, 2025

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Mbështetja tek Allahu - adhurim madhështor

Allahu e ka lartësuar shumë çështjen e mbështetjes tek Ai dhe e ka bërë atë një prej veprave më madhështore të cilën besimtari mund ta bëjë me zemrën e tij. Mbështetja – tewekuli është adhurim i cili duhet t'i kushtohet vetëm Allahut. Besimtari nuk i mbështetet askujt tjetër përveç Allahut. Kur njeriu i mbështetet Allahut, atëherë vetëm tek Ai do të shpresojë, në arritjen e qëllimeve të tij dhe në largimin e gjërave të cilave u frikësohet.

Ky adhurim është obligim fetar, dhe njësimi i Allahut me këtë adhurim madhështor është prej teuhidit. Ndërsa, kush i mbështetet dikujt tjetër përveç Allahut, ka bërë shirk i cili nxjerr prej Islamit. Mbështetja tek Allahu është kusht që tregon për saktësinë e Islamit dhe të besimit të personit.

Adhurimet që kryen njeriu janë të shumta. Kemi adhurime të brendshme, siç është shpresa, frika, mbështetja, dashuria, madhërimi etj., dhe kemi adhurime të jashtme siç është: namazi, agjërimi, zekati, haxhi, umreja, therja e kurbanit, lutja etj. Të

gjitha këto adhurime që bën njeriu, duhet t'i drejtohen dhe kushtohen vetëm për Allahun – Ai është i Cili i meriton ato.

Dhe siç u citua, mbështetja tek Allahu është adhurim i zemrës dhe është prej adhurimeve më të vlefshme. Shumë prej njerëzve bien në mëkate të zemrës dhe nuk e vërejnë këtë (prej tyre: mendjemadhësia, mosmbështetja tek Allahu, zilia, urrejtja etj.), madje disa u kushtojnë më shumë rëndësi disa mëkateve më të vogla sesa këtyre. Kështu, shumë njerëz braktisin mbështetjen tek Allahu dhe mbështeten në shkaqe sipërfaqësore për të arritur një gjë.

Mbështetja tek Allahu është shkak për të arritur dashurinë e Allahut. Ai thotë: **“Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”** Ali Imran 159. Ndikimi që besimtari përfiton prej këtij adhurimi, është shumë i madh, në këtë jetë dhe tjetrën.

Ky adhurim është shkak për të hyrë në Xhenet. Allahu thotë: **“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i vendosim në pallatet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj; aty do të qëndrojnë përgjithmonë. Sa i bukur është shpërblimi i atyre që punojnë mirë, e të cilët kanë duruar dhe janë mbështetur te Zoti i tyre.”** Ankebut 58-59. Po ashtu, përmes mbështetjes tek Allahu njeriu do të gjejë qetësinë shpirtërore.

Gjithashtu përmendim disa ajete të tjera që flasin për këtë adhurim: **“Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem.”** Hud 88. Dhe: **“Adhuroje Allahun dhe mbështetu tek Ai!”** Hud 123. Dhe: **“Mbështetu në të Gjithëjetshmin, i Cili nuk vdes**

kurrë dhe madhëroje Atë me falënderim!” Furkan 58. Dhe: “Më mjafton Allahu, s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh!” Teube 129. Pejgamberi salAllahu alejhi ue sem ka thënë: “Kush dëshiron që të jetë njeriu me besimin më të fortë, le t’i mbështetet Allahut!” Hakimi. Dhe: “Nëse ju do t’i mbështeteshit Allahut siç e meriton, Ai do t’iu furnizonte siç i furnizon shpendët. Ata dalin në mëngjes me barkun bosh dhe kthehen në mbrëmje me barkun plotë.” Ahmed, ibën Maxhe.

a. Përkufizimi dhe realiteti i tewekulit

Imam Ahmed ka thënë: *“Tewekuli është shkëputja e shpresave ndaj njerëzve dhe drejtimi i shpresave vetëm tek Allahu.”*

Shejh Uthejmini (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Tewekuli është mbështetja tek Allahu në arritjen e synimeve dhe në largimin e gjërave të urryera, me besim dhe bindje të plotë tek Ai dhe njëkohësisht duke vepruar shkaqet e lejuara sheriatikisht.”* Kjo na tregon se për t’u llogaritur se dikush i është mbështetur Allahut vërtet, atëherë duhet të posedojë dy gjëra: 1. Kjo mbështetje të jetë e sigurtë, 2. Të veprojë shkaqet e lejuara sheriatikisht.

Fudajl ibën Ijadi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Sikur njeriu t’i shkëpuste të gjitha shpresat ndaj krijesave në atë që dëshiron, pasha Allahun, Ai do t’i jepte çdo gjë që dëshiron.”*

Dijetari el Xhurxhani (Allahu e mëshiroftë!): *“Tewekuli është të kesh besim e bindje të plotë në atë që është tek Allahu, dhe nga ana tjetër, të mos mbash shpresë në atë që është në dorën e njerëzve.”*

Realiteti i tewekulit është që njeriu të dijë se i gjithë sundimi dhe universi është në Dorën e Allahut dhe Ai e drejton atë sipas dëshirës dhe vullnetit të Tij. Andaj, të gjitha çështjet e tua duhet t’ia besosh Allahut dhe të kërkosh strehë e mbrojtje tek Ai me zemrën tënde. Besimtari duhet të lidhë zemrën e tij për Allahun, nevojën dhe qëllimin që ka t’ia drejtojë Atij dhe çështjet t’ia dorëzojë Atij, pastaj dhe të veprojë shkaqet të cilat na ka urdhëruar Ai për të arritur atë qëllim. Thelbi i tewekulit është që të gjitha çështjet e tua t’ia dorëzosh Allahut. Ndërsa, veprimi i shkaqeve nuk e mohon dhe nuk e kundërshton mbështetjen tek Allahu.

b. Kthimi i zemrës kah Allahu, e jo kah shkaqet

Zemra e besimtarit duhet të kërkojë strehë dhe mbrojtje vetëm tek Allahu. Shpresat për të arritur atë që synon duhet t’i drejtohen vetëm Allahut, i Cili e drejton këtë univers, ndërsa krijesa nuk ka asgjë në dorë, por thjeshtë është shkak, dhe përderisa është shkak, atëherë nuk lejohet mbështetja në shkaqe. Ai që mbështetet te dikush tjetër apo e lidh zemrën për dikë tjetër e jo për Allahun, do të humbasë. Pastaj, kur njeriu vepron shkaqet, atëherë dobia që vjen si rezultat i shkakut, është në Dorën e Allahut e jo në dorën e krijesës.

Prej thelbit të veçimit të Allahut me adhurim (teuhidit) është të shikuarit e çështjeve se të gjitha ato janë prej Allahut, shikim ky që shkëputë çdo lidhje apo kthim kah shkaqet apo gjërat ndërmjetësuese. Andaj, shkaqet duhet të shikohen vetëm si krijim dhe caktim i Allahut, sepse Ai është Krijuesi, Ai i Cili i drejton çështjet në këtë univers, Ai që zotëron sundimin etj. Nuk ka mundësi të lëvizë diçka apo të mos lëvizë (të rrijë qetë) veçse me caktimin e Allahut. Ky nivel i besimit, si rezultat do të sjellë tewekulin te personi, kënaqjen me Allahun dhe dorëzimin ndaj urtësisë së Tij. Mirëpo, që ta kufizojmë shikimin tonë dhe ta hedhim vetëm kah shkaqet fizike, kjo është mangësi në besim dhe dobësi në teuhid. Ai që e njëson Allahun me teuhid dhe është i sinqertë, kur vepron një shkak, do ta dijë bindshëm se Allahu e ka krijuar atë shkak, e ka caktuar atë dhe e ka nënshtuar dhe vënë në shërbim të tij. Besimtari përmes shkaqeve arrin te rezultatet (tek të shkaktuarat). Ai edhe nëse i vepron shkaqet, këtë e bën me gjymtyrët e tij ndërkohë që zemra e tij është e lidhur me Atë në Dorën e të Cilit është pushteti dhe zotërimi i çdo gjëje. Në zemrën e tij nuk kanë hise shkaqet, pra nuk ka hise mbështetja në shkaqe. Ndërsa, nga ana tjetër, zhvlerësimi i shkaqeve është mangësi në mendje. Kurse heqja dorë prej shkaqeve, është akuzë dhe fyerje ndaj fesë. Njësuasi i Allahut nuk kthehet me zemrën e tij kah shkaqet, qëllimi është: nuk gjen qetësi në to, nuk ua beson çështjen e tij shkaqeve, nuk mbështetet tek to, nuk ka shpresë e frikë ndaj tyre, por as nuk i neglizhon, as nuk i shpërfillë e as nuk i lë pa vepruar. Zemra e tij gjen qetësi vetëm tek Allahu. Kush

bën bashkë mes teuhidit dhe vërtetimit e pohimit të shkaqeve, ai është duke ndjekur rrugën e drejtë.

Të gjitha çështjet duhet t'ia dorëzojmë dhe t'ia besojmë Allahut, duke mos u mbështetur në forcat personale e as te njerëzit. Ata dhe aftësitë tona duhet t'i konsiderojmë vetëm shkaqe. Shkaku ose ndikon ose nuk ndikon. Nëse nuk do Allahu që shkaku të ketë ndikim, atëherë nuk do të ketë, edhe pse është një shkak të cilin Ai e ka krijuar të ndikojë. Mbështetja në Allahun nuk do të thotë që të mos veprohen shkaqet. Ato i vepron, mirëpo jo t'iu mbështetesh. I sëmuri që pi ilaçe, nuk duhet t'i mbështetet ilaçit e të mendojë e besojë se me pirjen e tij do t'i largohet sëmundja. Jo, por duhet t'i mbështetet Allahut, ndërsa ilaçin ta konsiderojë vetëm si shkak, që nëse do Allahu ai e bën ndikimin e vet. Shohim raste kur njeriu është i sëmurë dhe e pi ilaçin, por nuk përfiton prej tij, edhe pse dikush tjetër me të njëjtën sëmundje pi të njëjtin ilaç dhe shërohet. Kështu sepse çdo gjë është në Dorën e Allahut.

Për aq sa njeriu i mbështetet shkaqeve (logjikës, ilaçit, rukjes, fuqisë, punës etj.), për aq i pakësohet mbështetja e tij tek Allahu. Ndërsa, ai që i mbështetet Allahut duke i larguar plotësisht shkaqet, e ka akuzuar urtësinë e Allahut, sepse Ai ka bërë që çdo gjë që ndodhë në këtë univers të ketë shkakun e vet. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka qenë ai i cili më së shumti i është mbështetur Allahut e megjithëkëtë ka vepruar shkaqet (në udhëtim ka marrë ushqim me vete, ka veshur dy parzmore në betejën e Uhudit etj.). Muslimani e ka për obligim të pajiset me tewekul në të gjitha çështjet e tij, të fesë dhe të dunjasë, sepse

Allahu është Ai i Cili e ndihmon dhe e mbron – të ketë bindje dhe mirëbesim tek Ai, mirëpo krahas kësaj të veprojë shkaqet.

Shembuj:

-Mund të takosh personin (për të ta zgjidhur një problem, për të të ndihmuar etj.) sepse kjo është prej shkaqeve të arritjes së dobive të kësaj jete, por kur takohesh me të, nuk e kthen zemrën kah ai, por e kthen kah Allahu dhe e lë çështjen në Dorën e Tij.

-Mund të bësh rukje kur ke nevojë për këtë, por duhet të dish se rukja është vetëm shkak, e Ai që shëron është vetëm Allahu i Madhërihem.

c. Teweduli te dikush tjetër përveç Allahut

1. *Teweduli i adhurimit dhe nënshtrimit* – Ky lloj i tewekulit është obligim t'i kushtohet sinqerisht vetëm Allahut. Kur dikush ia kushton dhe dedikon atë dikujt tjetër: i mbështetet dikujt tjetër përveç Allahut, duke besuar se ai ia sjell të mirat e ia largon dëmet dhe në zemrën e tij ka ndjenjën se është nevojtar për të, *edhe pse nuk ka kompetencën dhe mundësinë të bëjë këto gjëra*, i tilli ka bërë shirk të madh, siç është rasti i atyre që u mbështeten evliave, të vdekurve etj. Ata u drejtohen me zemër varreve dhe të vdekurve dhe ua dorëzojnë çështjet atyre. Kjo është shirk sepse kështu personi beson se dikush tjetër përveç Allahut ka një lloj mundësie të veprojë pavarësisht Allahut e të drejtë një pjesë të universit. Shembuj: Mbështetja ndaj krijesës për të t'i falë mëkatet, të të

sjellë shpërblimet e ahiretit, të të japë pasardhës, të të bëjë të fitosh një vend pune etj.

2. *Tewekuli në shkaqe të jashtme, të dukshme* – Kur njeriu i mbështetet një personi (drejtorit, udhëheqësit) për furnizim, për arritjen e dobive, për largimin e të këqijave etj. Shembull: Ka njerëz që i mbështeten vendit të punës për të fituar furnizimin dhe kështu kanë ndjesinë se janë nevojtarë për vendin e punës dhe se nëse nuk do ta kishin atë, atëherë nuk do të furnizoheshin, andaj u bëjnë edhe lajka drejtorëve dhe punëdhënësve për të mos e humbur vendin e punës, me pretendimin se në dorën e tyre është furnizimi i tyre. Dijetarët thonë se ky lloj i tewekulit është shirk i fshehtë – i vogël.

3. *Autorizimi i dikujt*– Kur njeriu e autorizon dikë të kryejë një punë. Shembull: Të blejë apo të shesë diçka për të. Kjo është e lejuar dhe nuk ka të bëjë me mbështetje. Mirëpo, dijetarët thonë se edhe kur e autorizon dikë për të kryer një punë për ty, nuk është e lejuar t'i mbështetesh atij, por duhet të mbështetesh tek Allahu, i Cili ta ka lehtësuar dhe mundësuar që ai person të kryejë në vendin tënd atë që ke nevojë.

d. Kush i mbështetet Allahut, Ai do t'i mjaftojë atij

Kush i mbështetet Allahut, Ai do t'i mjaftojë atij për të gjitha brengat, synimet dhe nevojat e tij. Ky është rezultat i tewekulit. Allahu thotë: **“Kushdo që mbështetet tek Allahu, Ai i mjafton**

atij.” Talak 3. Ibn Sadi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: *“Kushdo që i mbështetet Allahut në çështjet e fesë dhe të dunjasë dhe vetëm prej Tij pret dobitë dhe largimin e të këqijave, atëherë Ai do t’ia lehtësojë çështjet dhe Ai do t’i mjaftojë atij.”* Do t’i mjaftojë ndaj gjërave të cilat e brengosin, do t’ia largojë vështirësitë dhe do t’ia lehtësojë ato.

Ne duhet ta dimë se Urtësia e Allahut, nganjëherë e kërkon që ndonjë çështje për të cilën i mbështetemi Atij, të vonohet për një kohë (të mos realizohet ajo që synojmë), deri kur është më e përshtatshme të realizohet, sepse Ai e di e di se çfarë është më e dobishme për ne. Allahu thotë: **“Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë.”** Talak 3. Edhe nëse ndodh të kemi ndonjë vuajtje apo brengë, Allahu do të marrë përsipër çështjet tona, do të bëhet Mbrojtësi ynë, do të na mjaftojë dhe nuk do të dëmtohem.

Kur Allahu i mjafton njeriut, atëherë ai do të fitojë të mirat e kësaj bote dhe të ahiretit dhe nuk do të ketë frikë askënd tjetër përveç Tij. Kur Allahu është me të, atëherë do ta dijë se askush nuk mund ta mposhtë dhe ta mundë. Atë që Allahu e ndihmon, nuk mundet ta ngadhënjejë askush. Ndërsa, kush i mbështetet dikujt tjetër apo diçkaje, do të tradhtohet ngase askush nuk ka mundësi t’i mjaftojë atij.

Argumentet që flasin për tewekulin

Ajeti kuranor: **“Vetëm Allahu mbështetjuni!”**

Allahu thotë: **“وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ”** - **Vetëm Allahu mbështetjuni** (askujt tjetër përveç Tij), **në qoftë se jeni besimtarë.** Maide 23. Përderisa Allahu na ka urdhëruar t'i mbështetemi vetëm Atij, atëherë tewekuli është adhurim, dhe përderisa është adhurim, atëherë vetëm Allahu duhet të veçohet me të.

Gjithashtu ajeti tregon se besimi nuk është i saktë përveçse me tewekul dhe se ai është kusht për besimin e saktë të personit. Nëse në zemrën e personit nuk ka mbështetje tek Allahu, por i mbështetet krijesës në gjëra që nuk janë në mundësinë e saj, atëherë kjo tregon se tek ai nuk gjendet thelbi dhe origjina e besimit. Nëse i mbështetet pjesërisht, atëherë për aq i mangësohet edhe mbështetja tek Allahu.

Tewekuli është provë dhe dëshmi e besimit të njeriut dhe është një gjë që e kërkon ai. Një zemër që nuk ka tewekul, realisht nuk ka as besim të saktë. Allahu thotë: **“Vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët.”** Ibrahim 11. Ibën Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Këtu Allahu përmend vetëm besimin e jo emërtimet e tjera (Islami, ihsani etj.), dhe kjo është dëshmi se besimi e kërkon patjetër mbështetjen tek Allahu dhe tregon se forca apo dobësia e mbështetjes tek Ai është në varësi të forcës apo dobësisë së besimit. Sa më shumë që forcohet besimi, aq më shumë forcohet mbështetja tek Ai, dhe e kundërta.*

Nëse mbështetja tek Allahu është e dobët, kjo është dëshmi se edhe besimi është i dobët. Allahu i Lartësuar në Kuran bën bashkë mes mbështetjes tek Ai dhe adhurimit, mes mbështetjes tek Ai dhe besimit, mes mbështetjes tek Ai dhe devotshmërisë, mes mbështetjes tek Ai dhe Islamit, mes mbështetjes tek Ai dhe udhëzimit. Në këtë mënyrë na bëhet e qartë se mbështetja tek Allahu është baza e të gjitha niveleve të Islamit, imanit dhe ihsanit. Andaj, pozita e mbështetjes tek Allahu në raport me këto që u përmenden, është si pozita e kokës ndaj trupit.”

Hadithi: “O Allah, Vetëm tek Ti jam mbështetur!”

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“O Allah, Ty të jam dorëzuar, Ty të kam besuar. Vetëm tek Ti jam mbështetur dhe tek Ti kthehem!”** Muslimi.

اللَّهُمَّ لَكَ أَسَلْتُ ، وَبِكَ آمَنْتُ ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ ، وَإِلَيْكَ أُنَبْتُ

“Vetëm tek Ti jam mbështetur” - Do të thotë: Vetëm Ty t’i kam besuar çështjet e mia, tek Ti mbështetem në rregullimin dhe drejtimin e tyre. Ky hadith na tregon se besimtari e ka për obligim t’i mbështetet Allahut, të Vetmit, sepse Ai cilësohet me Cilësi të përsosura, andaj Ai është i Vetmi i cili meriton t’i mbështetemi.

Shumë njerëz i mbështeten Allahut vetëm për çështjet e kësaj bote, si: kur dëshirojnë të arrijnë një sukses në biznes, apo të përfundojnë universitetin, apo të kalojnë një provim, apo të realizojnë një projekt e të tilla. Mirëpo, të paktë janë ata që i

mbështeten Allahut për gjërat e fesë, gjë për të cilën realisht ne duhet t'i mbështetemi Atij më shumë sesa për gjërat e kësaj jete.

Nga gjërat parësore për të cilat duhet t'i mbështetemi Allahut është *përmirësimi i fesë sonë*. Kush është ai i cili i mbështetet Allahut në përmirësimin e besimit të tij, apo të zemrës së tij, apo të namazit të tij? Apo në kërkimin e dijes – të kuptojë Kuranin dhe sunetin? Pra, muslimani fillimisht duhet t'i mbështetet Allahut në çështjet e fesë e pastaj edhe në çështjet e kësaj bote.

Në këtë hadith, së pari përmendet Islami (“**Ty të jam dorëzuar**”), që tregon për dorëzim të jashtëm (me vepra të jashtme) dhe pastaj përmendet imani (“**Ty të kam besuar**”), që tregon për dorëzim të brendshëm (me zemër).¹ E prej besimit është mbështetja tek Allahu. Kur njeriu arrin të realizojë besimin e plotë, atëherë rrjedhimisht do t'i mbështetet plotësisht Allahut. Ai që mbështetet tek Allahu dhe kërkon mbrojtje tek Ai, do të jetë i shpëtuar e i udhëzuar dhe do të arrijë krenarinë e fuqinë në këtë botë.

Prej tipareve të muslimanit duhet të jetë mbështetja tek Allahu, sidomos në situata kritike, shqetësime, brenga, mundime etj. Allahu na ka urdhëruar që gjithmonë t'i mbështetemi Atij. Mbështetja tek Allahu i mjafton për çdo gjë që e shqetëson dhe e brengos – Allahu do t'i mjaftojë atij. Ai thotë: “**A nuk i mjafton**

¹ Ndërsa, kur përmendet vetëm njëra, atëherë Islami e përfshin imanin dhe imani e përfshin Islamin.

Allahu rob it të Vet?!" Zumer 36. Allahu është i vetmi i Cili e ndihmon, e përkrahë dhe i Cili është i Fuqishëm për çdo gjë.

Mbështetja tek Allahu ka qenë metodologjia e të gjithë Pejgamberëve. Ata në thirrjen e tyre i janë mbështetur vetëm Allahut dhe nuk e kanë përshpejtuar rezultatin e kësaj thirrje. Muslimanët dhe thirrësit për tek Allahu nuk duhet të kaplohen nga frika, por duhet të jenë të bindur në ndihmën dhe fitoren prej Allahut.

Ajeti kuranor: **"Mbështetu në të Gjithëjetshmin"**

Allahu thotë: **"وَتَوَكَّلْ عَلَى الْحَيِّ الَّذِي لَا يَمُوتُ وَسَبِّحْ بِحَمْدِهِ"**- **Mbështetu në të Gjithëjetshmin, i Cili nuk vdes kurrë dhe madhëroje Atë me falënderim!"** Furkan 58. Mbështetu tek Allahu në të gjitha çështjet e tua, të vogla apo të mëdha, ngase pa t'i lehtësuar Allahu çështjet, ato nuk do të jenë të lehta për ty.

Dhe pikërisht prej shkaqeve të lehtësimit është t'i mbështetesh Atij. Andaj, sa herë që të godasin sprovat e fatkeqësitë dhe shtohen brengat, dije se nuk ka strehë diku tjetër për ty veçse tek Allahu.

Mbështetja nuk duhet të jetë tek ai i cili është i vdekur, që cilësohet me këtë, por duhet të jetë vetëm tek Ai i Cili është i Gjallë dhe që nuk vdes kurrë. Ajeti na jep shenjë se përderisa Allahu është i Gjalli, i Përhershmi, pa fillim dhe pa mbarim,

atëherë tek Ai duhet të kesh besim të plotë se do t'i sjellë të mirat dhe do t'i plotësojë nevojat, ndërsa ata që nuk kanë jetë të përhershme nuk meritojnë që t'iu mbështetemi. Jeta e Allahut është e plotë, e përsosur, e cila kurrë nuk do të përfundojë e nuk do të zhduket.

Allahu në këtë ajet, sikur do të na thotë se kush i mbështetet dikujt tjetër përveç Allahut, atëherë i është mbështetur krijesës e cila vdes e tretet. Në këtë mënyrë, ai do të jetë i humbur dhe përpjekjet e tij do të shkojnë huq. Allahu do ta lërë në zgjedhjen që ka bërë dhe nuk do të ketë kurrë mundësi të realizojë qëllimet e tij.

Hadithi: “**Jam mbështetur tek Allahu**”

Transmetohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush thotë kur del prej shtëpisë së tij: **“Me emrin e Allahut! Jam mbështetur tek Allahu. Nuk ka ndryshim dhe forcë veçse me Allahun!”**,²

بِسْمِ اللَّهِ ، تَوَكَّلْتُ عَلَى اللَّهِ ، وَلَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ

² “Nuk ka ndryshim dhe forcë veçse me Allahun – La hawle we la kuwwete il-la bil-lah” është prej thesareve të Xhenetit, siç ka thënë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Kjo sepse ajo ka kuptime dhe domethënie madhështore.

do t'i thuhet: “Je udhëzuar, je mjaftuar dhe je mbrojtur dhe prej teje është larguar shejtani.” Tirmidhiu dhe të tjerë.

-**“Jam mbështetur tek Allahu”** – Të gjitha çështjet e mia ia besoj dhe ia dorëzoj Allahut, me besim dhe mendim të mirë ndaj Tij, duke i kërkuar Atij të më mundësojë t'i arrij ato gjëra të cilat i synoj.

Kur njeriu del prej shtëpisë, është krijesë nevojtare dhe e dobët dhe ka nevojë t'i mbështetet Allahut që ta ruajë, ngase në këtë rast do t'i ekspozohet gjërave që mund ta dëmtojnë (qoftë prej njerëzve, apo kafshëve, apo aksidenteve, apo lëndimeve etj.). Allahu thotë: **“Thuaj: “Kush do t’ju ruajë natën dhe ditën...”** Enbija 42.

Dhe shpërblimi vjen në bazë të llojit të veprës. Nëse besimtari ia dorëzon dhe ia beson çështjet e tij Allahut, atëherë do shpërblehet me udhëzim, mjaftueshmëri dhe mbrojtje prej shejtanit. Pra, do të jetë i udhëzuar prej Allahut, në fjalët e tij, në veprimet e tij, në çdo situatë nëpër të cilën kalon, do të mjaftohet prej çdo brengje, preokupimi e shqetësimi të kësaj bote apo të botës tjetër, Allahu do të largojë prej tij çdo të keqe dhe çdo gjë që mund ta dëmtojë, do të mbrohet prej litarëve dhe rrjetave që hedh shejtani për ta larguar nga rruga e drejtë, do të mbrohet prej cytjeve të tij dhe gjërave të fshehta që mund ta dëmtojnë dhe prej tij do të largohet shejtani.

Kur ne i mbështetemi Allahut dhe kërkojmë strehë e mbrojtje tek Ai, atëherë kjo do të jetë shkak që të mbrohemi prej dëmeve të

ndryshme. Kjo është fortifikata më e fortë me të cilën mbrohet besimtari. Kushdo që i mbështetet Allahut, Ai do t'i mjaftojë atij.

Tewekuli është prej llojeve më përmbledhëse të adhurimit dhe niveleve më të larta të teuhidit. Të gjithë ne duhet t'iu tregojmë të tjerëve për rëndësinë e mbështetjes tek Allahu dhe se çfarë rezultate të mira sjell ajo. Allahu thotë: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten, ata që falin namazin dhe japin prej asaj që Ne ua kemi dhënë.”** Enfal 2. Ibën Kethiri (Allahu e mëshiroftë!) për pjesën: **“vetëm te Zoti i tyre mbështeten”**, ka thënë: *“Ata nuk i varin shpresat te dikush tjetër dhe nuk e synojnë dikë tjetër përveçse Allahun, nuk kërkojnë strehë e mbrojtje te dikush tjetër përveçse te madhështia e Allahut, të gjitha nevojat i kërkojnë vetëm prej Tij, dëshirat e tyre i drejtojnë vetëm tek Ai...”*

Sejid ibn Xhubejri ka thënë: *“Mbështetja tek Allahu është ajo e cila përmbledh tërë besimin.”* Allahu e ka kushtëzuar besimin tonë me mbështetjen tek Ai, siç thotë: **“Vetëm Allahut mbështetjuni** (askujt tjetër përveç Tij), **në qoftë se jeni besimtarë.”** Maide 23. Dhe: **“Allahu është Ai që përveç Tij, nuk ka të adhuruar tjetër me meritë, prandaj vetëm tek Ai le të mbështeten besimtarët.”** Tegabun 13. Ibën Sadi ka thënë: *“Allahu na tregoi në këtë ajet se vetëm Ai është i Cili meriton adhurimin dhe ulubijen dhe se çdo gjë që adhurohet përveç Tij, është adhurim i kotë dhe i padrejtë. Le t'i mbështeten Allahut për të gjitha gjërat që u kanë ndodhur dhe ato që synojnë t'i veprojnë, ngase asnjë gjë nuk mund të lehtësohet përveçse me ndihmën e*

Allahut dhe duke iu mbështetur Atij. Mbështetja tek Allahu nuk është e plotë përderisa njeriu nuk ka mendim të mirë ndaj Tij - mirëbesim se Ai do t'i mjaftojë. Kur arrin të realizojë këto gjëra, e ka realizuar mbështetjen tek Allahu. Mirëpo, kjo varet nga besimi që ka personi. Sa më i fortë që është besimi i tij, edhe mbështetja e tij tek Allahu është e madhe, dhe e kundërta.”

Ajeti kuranor: **“vetëm te Zoti i tyre mbështeten”**

Allahu thotë: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu,³ fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij,⁴ u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten, ata që falin namazin dhe japin prej asaj që Ne ua kemi dhënë. Njëmend, ata janë besimtarë të vërtetë.”** Enfal 2-4. Ky ajet përmbledh pesë cilësi të besimtarëve.

Prej tyre: **“وَعَلَى رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ”**- vetëm te Zoti i tyre mbështeten”.

Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftël!) thotë: *“Ata me zemrat e tyre i mbështeten vetëm Allahut dhe të gjitha çështjet e tyre ia besojnë Atij, të Vetmit, ngase e dinë se Ai nuk ka ortak. Andaj, nuk shpresojnë tek askush tjetër përveçse tek Allahu, nuk e synojnë askënd tjetër përveçse Atë.*

³ Kur përmendet madhëria e Allahut, madhështia e Tij, pushteti e Fuqia e Tij. Ato zemra ndikohen nga përmendja e Allahut.

⁴ I dëgjojnë me vëmendje ajetet dhe kanë zemra të pranishme, ngase meditojnë rreth tyre, dhe kjo ua shton besimin.

Ata e dinë se ajo që do Allahu, bëhet e ajo që nuk do Ai, nuk ka mundësi të bëhet. Ai është i Vetmi i Cili vepron dhe e drejton këtë univers. Allahu në këtë ajet i përshkruan besimtarët e vërtetë me tre prej niveleve më të larta të ihsanit: 1. Frika ndaj Allahut, 2. Shtimi i besimit, 3. Mbështetja tek Allahu...”

Këto adhurime janë prej niveleve më të larta të besimtarëve. Andaj, duhet t’iu kushtojmë kujdes dhe të shohim te vetja jonë se a i kemi këto cilësi apo jo, sepse të gjitha çështjet e fesë dhe veprat që vepron njeriu, rezultojnë prej këtyre adhurimeve që përmenden në ajet.

“Njëmend, ata janë besimtarë të vërtetë.” – Sepse ata kanë bërë bashkë mes imanit dhe Islamit, mes veprave të brendshme dhe të jashtme, mes dijes dhe veprës, mes së drejtave të Allahut dhe të njerëzve.

Besimtari nuk duhet t’i mbështetet njerëzve ngase ata janë krijesa sikurse ai. Atyre nuk u intereson t’i sjellin dobi të mëdha, madje edhe nëse do t’i sillnin ndonjë dobi, ajo do të ishte e mangët – jo siç do të dëshironte ai. Ndërsa, kur i mbështetet Allahut, Ai do t’i mjaftojë për të gjitha çështjet e tij, qofshin çështje të fesë apo të dunjasë.

Dhe, pas këtyre ajeteve, Allahu përmend shpërblimin e përgatitur për këta besimtarë të vërtetë, thotë: **“Ata do të kenë shkallë përnderimi te Zoti i tyre, falje dhe furnizim bujar (në Xhenet).”** Enfal 54.

Si arrihet mbështetja tek Allahu?

Mbështetja tek Allahu ka vlerë shumë të madhe. Disa prej selefit kanë thënë: *“Të mjafton si afrim tek Allahu që Ai e di se sa mbështetje të madhe e të mirë ke tek Ai në zemrën tënde. Sa shumë njerëz ka të cilët ia kanë besuar dhe dorëzuar çështjet Allahut, dhe Ai u ka mjaftuar për çdo gjë e cila i ka brengosur dhe shqetësuar.”* Andaj, themi se tewekuli ka dy baza, që janë: Mirësbesimi dhe mbështetja plotësisht tek Ai. Në këtë mënyrë njeriu realizon kuptimin e ajetit: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**

Dijetarët kur kanë folur për tewekulin kanë thënë se ai ka tri nivele: 1. *Mbështetja*, 2. *Dorëzimi*, 3. *Mirësbesimi*. Ai që arrin nivelin e parë, ndihet i qetë shpirtërisht dhe mendërisht në premtimin e Allahut. Ai që arrin nivelin e dytë, mjaftohet që Allahu e di gjendjen e tij. Ai që arrin nivelin e tretë, është i kënaqur me atë që Cakton Allahu për të.

Muslimani gjithmonë duhet të ketë mbështetje tek Allahu dhe bindje e mendim pozitiv për Atë, se Ai do t’ia përmirësojë e do t’ia rregullojë gjendjen, do t’i bëjë zgjidhje etj. Ne si muslimanë duhet t’i nxisim dhe t’i ftojme njerëzit që t’i mbështeten Allahut dhe që të kërkojnë ndihmë vetëm tek Ai, dhe kështu Ai do të bëhet ndihmuesi dhe përkrahësi ynë dhe do të përmbushë nevojat tona.

a. Veprimi i shkaqeve dhe përpjekja

Dijetarët kanë njëzëshmëri në lidhje me atë se tewekuli nuk e kundërshton veprimin e shkaqeve, madje ai nuk është në rregull pa u vepruar shkaqet. Mirëpo, duhet të jemi të bindur se Ai që sjell dobinë e largon dëmin është Allahu (shkaqet nuk ndikojnë vetvetiu). Disa njerëz gabimisht mendojnë se kuptimi i tewekulit është të mos ndërmarrësh shkaqet – t'i braktisësh ato. Veprimet të shkaqeve duhet t'ia bashkëngjisim edhe kërkimin e ndihmës prej Allahut, mbështetjen tek Ai dhe besimin se Ai do të na ndihmojë. Kështu ka vepruar Jakubi alejhi ue selam kur ka vepruar shkaqet për mbrojtjen e bijve të tij, që të mos u ndodh ndonjë e keqe, ai ka thënë: **“Allahu është Ruajtësi më i mirë...”** Ajeti 64.

Në një hadith Pejgamberi salAllahu alejhi ue selam ka thënë: **“Sikur ju t'i mbështeteshit Allahut me mbështetje të vërtetë, atëherë Ai do t'iu furnizonte siç i furnizon zogjtë, të cilët dalin në mëngjes me barkun bosh dhe kthehen në mbrëmje me barkun plotë.”** Pikërisht nga ky hadith marrim udhëzime të shëndosha se si duhet t'i mbështetemi Allahut me mbështetje të vërtetë. Ibën Rexhebi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *“Ky hadith është bazë sa i përket tewekulit dhe na tregon se ai është shkaku kryesor për arritjen e furnizimit. Siç ka thënë Allahu: “Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai.” Talak 2-3. Nëse njerëzit do të realizonin devotshmërinë dhe mbështetjen tek Allahu, atëherë Ai do t'iu mjaftonte për*

arritjen e dobive të fesë dhe të kësaj jete.” Mbështetja e vërtetë pa dyshim se ka ndikim të madh në jetën e njeriut. Ajo e detyron atë të jetë i kënaqur me çdo gjë që Allahu ia ka caktuar dhe të mos jetë lakmitar i madh apo ta teprojë në kërkimin e furnizimit. Mbështetja e vërtetë gjithashtu nuk e lejon të ankohet tek krijesat për mosfurnizim dhe mossukses.

Dhe mbështetja e vërtetë është kur bëhet bashkë me vepra të mira dhe përpjekje të duhura. Këto përpjekje njeriu i vepron:

- për të përfituar një gjë të dobishme që nuk e ka,
- për të ruajtur një gjë të dobishme që ka,
- për të larguar një gjë të dëmshme që nuk ka ndodhur,
- për të larguar një gjë të dëmshme që ka ndodhur.

Zogitë edhe pse i mbështeten Allahut, megjithatë nuk qëndrojnë pa vepruar – i ndërmarrin shkaqet: “...**dalin në mëngjes me barkun bosh dhe kthehen në mbrëmje me barkun plotë**”. Kjo gjë vazhdimisht ndodh tek ta. Andaj, përmendja e lëvizjes së zogjve në këtë hadith, na udhëzon në atë se është e domosdoshme të veprojmë e të japim përpjekjen tonë,⁵ përveç mbështetjes tek Allahu.

⁵ Besimtari duhet të kërkojë furnizimin, ose të bëjë shitblerje, ose të merret me zanate, dhe njëkohësisht duhet t’i mbështetet Allahut. Ai nuk duhet të tregohet i shkujdesur e të ulet me përtaci në shtëpinë e tij duke pritur furnizimin e tij- kjo nuk është prej udhëzimit të Islamit dhe as prej tipareve të burrave dhe të besimtarëve.

El Bejhekiu ka thënë: “Në këtë hadith nuk ka argument që njeriu të qëndrojë ulur e të mos e kërkojë furnizimin, përkundrazi ai duhet ta bëjë këtë. Qëllimi i hadithit është se sikur njeriu t’i mbështetet Allahut sa herë që del e kthehet në shtëpi dhe ta dinte se të gjitha të mirat janë në dorën e Allahut dhe vijnë prej Tij,⁶ atëherë ai do të kthehej në shtëpinë e tij shëndoshë dhe me fitim të furnizimit, sikurse zogjtë, mirëpo problemi është se ai i mbështetet fuqisë e aftësisë së vet. Madje bën mashtrime e gënjeshtër në kontratat e shitblerjes me njerëzit (për të fituar furnizim), dhe kjo është në kundërshtim me tewekulin.” Mosveprimi i shkaqeve tregon për plogështi të personi, dhe një mbështetje e tillë nuk është e duhur dhe e drejtë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i është mbështetur Allahut në çdo gjendje dhe kërkimi i furnizimit është

Gjithashtu, studenti duhet të mësojë për të kaluar provimet dhe t’i mbështetet Allahut. I sëmuri duhet të shkojë të mjeku e të marrë ilaçin e duhur për t’u shëruar dhe t’i mbështetet Allahut të Vetmit e të dijë se shërimi është prej Tij.

⁶ Allahu e ka marrë përsipër furnizimin tonë. Shumë njerëz kanë mendim të keq ndaj Allahut kur nga frika për ngushtim dhe pakësim të furnizimit nuk bëjnë shumë fëmijë. Njeriu sado që ka shumë fëmijë, Allahu i jep dhe ia shton furnizimin që të shpenzojë për ta. Andaj, furnizimi i fëmijëve të tij, është në dorën e Allahut. Siç thamë shumë njerëz kanë mendim të keq ndaj Allahut e nuk i mbështeten Atij, porse u mbështeten gjërave materiale, nuk kanë largpamësi, nuk shikojnë në Forcën dhe Fuqinë e Allahut, i Cili është Furnizuesi i Vetëm dhe Ai i furnizon fëmijët edhe nëse ata janë shumë.

prej sunetit të tij. Andaj, kushdo që vepron sikurse ai, nuk duhet të braktisë sunetin e tij – që është dhe veprimi i shkaqeve.

Nëse do që të arrish Xhenetin, atëherë vepro shkaqet përmes së cilave e arrin atë. Nëse do që të ruhesh prej Xhehenemit, atëherë duhet të ruhesh prej shkaqeve që dërgojnë në të. Nëse do furnizim, atëherë duhet të veprosh shkaqet përmes të cilave të furnizon Allahu. Shumë njerëz tregohen dembelë e nuk kërkojnë furnizim, ndërsa disa të tjerë kalojnë në ekstremin tjetër duke u dhënë shumë pas kësaj dhe u mbështeten shkaqeve e nuk i mbështeten Allahut dhe nuk i varin shpresat tek Ai.

Mbështetja në Allahun është braktisja e mbështetjes në shkaqe pas veprimit të tyre. Ajo bën bashkë këto dy gjëra: veprimin e shkaqeve dhe mbështetjen në Allahun. Në një hadith gjejmë: **"Kushtoju rëndësi gjërave të dobishme dhe kërko ndihmën e Allahut e mos u trego i paaftë!"** Njeriu nuk ka detyrë tjetër veçse t'i veprojë shkaqet, kurse me zemër t'i mbështetet Atij i Cili i ka krijuar këto shkaqe – Allahut, dhe t'ia dorëzojë e besojë çështjet Atij. Nëse ia dorëzon dhe beson çështjet Allahut, atëherë Ai do t'i japë gjëra më të dobishme sesa ato që ka synuar.

Allahu ka caktuar ndodhinë e gjërave përmes shkaqeve të tyre (për të udhëtuar duhet zhvendosje e lëvizje, për t'u freskuar nga etja duhet pirë ujë, për të lindur fëmijë kjo duhet të bëhet përmes bashkimit të burrit dhe gruas me martesë). Kush do që të arrijë tek e shkaktuara duhet të veprojë patjetër shkaku e saj. Allahu i caktuar gjërat dhe i ka ndërlidhur me shkaqet e tyre. Njeriu më i

lumtur është ai i cili më së shumti vepron shkaqet, përmes të cilave arrin të realizojë dobitë e të dy botëve. E më i mjeri është ai u cili më së shumti i braktisë apo nuk i vepron ato.

Dhe rrjedhimisht, sa më shumë që i mbështetemi Allahut, aq më shumë vjen ndihma e Tij. Allahu thotë: **"Nëse ju ndihmon Allahu, s'ka kush t'ju mposhtë..."** Ali Imran 160. Problemi i myslimanëve sot është se ata u mbështeten më shumë shkaqeve të kësaj jete dhe mendojnë se ndihma është prej shkaqeve të tilla. Siç kemi sqaruar, nuk lejohet mbështetja në shkaqe (mirëpo ato veprohen). Këtu vjen në pah rëndësia e teuhidit. Kur besimtari e kupton forcën e fuqinë e Allahut, se si duhet të adhurohet Ai dhe se mbështetja është adhurim ndaj Tij, atëherë këtë adhurim do t'ia kushtojë vetëm Atij, e jo shkaqeve.

b. Disa gjëra që ndihmojnë në forcimin e tewekulit

- Pastrimi i teuhidit

Mbështetja e njeriut tek Allahu nuk mund të jetë e drejtë përveçse atëherë kur teuhidi i tij është i drejtë. Për aq sa e pastron atë prej shirkut të madh e të vogël,⁷ aq më e fortë do të jetë mbështetja tek Allahu, dhe e kundërta. Ai që dëshiron të jetë njeriu më i fortë shpirtërisht dhe fizikisht, le t'i mbështetet Allahut.

⁷ Secili prej nesh e ka teuhidin të pastër prej shirkut të madh, porse kush është ai i cili ia garanton vetes se nuk ka shirk të vogël.

- Meditimi në gjurmët e rububijes në univers.⁸ Sa më shumë që mediton rreth mbretërisë dhe sundimit të Allahut, të shtohet dija dhe do të dish se Allahu është i Vetmi i Cili e zotëron atë. Duke qenë kështu, atëherë Ai është i vetmi i Cili të ndihmon ty dhe ndihma që ta bën është shumë e lehtë për Atë. Në këtë mënyrë, do të të shtohet edhe mbështetja tek Allahu. Ai në zemrën e të cilit vendoset besimi (se Allahut i takon Sundimi i plotë, se Ai i Vetmi vepron dhe urdhëron në univers dhe Ai sjellë dobi e largon të këqijat), atëherë nuk do t'iu kushtojë rëndësi krijesave, por do t'i mbështetet vetëm Allahut.
- Bindja e thellë në paracaktimin e Allahut dhe në çështjet e gajbit (të së fshehtës).
- Bindja se çdo caktim i Allahut është i mirë për ty. Besimtari duhet të ndiejë se çdo gjë që zgjedh Zoti është më e mira për të, qoftë e dukshme apo e fshehur, gjë që sjell kënaqësi dhe siguri.
- Mendimi i mirë për Allahun. Mos e humb shpresën në përmbushjen e kërkesave, por të kesh mirëbesim në zemër se Allahu do të ndryshojë situatën në atë që është e mirë, sepse Ai, qoftë i Lartësuar, është i Fuqishëm për çdo gjë. Sa më

⁸ Dituria rreth Allahut të Madhërishtëm (Emrave dhe Cilësive të Tij).

shumë që përmirëson mendimin ndaj Allahut⁹ dhe sa më e madhe është shpresa tek Ai, aq do të jetë mbështetja tek Allahu. Këto çështje janë të lidhura me njëra-tjetrën. Ajo gjë që ndihmon të mos kesh mendim të keq ndaj Allahut është ta njohësh Atë dhe Emrat e Cilësitë e Tij. Njeriu duhet të mësojë për Allahun, duhet të shtojë dijen e njohurinë rreth Emrave dhe Cilësive të Tij. Kur e njeh Allahun, si rezultat do të ketë mendim të mirë dhe do ta dojë. Kështu, kur e di se Allahu është Falës, atëherë do të ketë mendim të mirë se Ai e fal kur i kërkon falje. Kur e di se Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë, do të ketë mendim të mirë se Ai e ndryshon gjendjen e tij për të mirë dhe ia largon sprovën, e kështu me radhë. Sa më shumë që mësojmë për Emrat dhe Cilësitë e Allahut dhe i kuptojmë drejtë e përpiqemi të punojmë me to në jetën e përditshme, atëherë rrjedhimisht na shtohet mendimi i mirë dhe mbështetja tek Ai. Dijetarët

⁹ Nëse njeriu ka lënë ndonjë gjë për hir të Allahut dhe mendon se Ai nuk do t'ia zëvendësojë me diçka më të mirë, apo nëse e vepron një vepër të mirë dhe mendon se nuk do t'ia shumëfishojë shpërblimin, apo nëse ka mbështetje të sigurtë tek Ai dhe mendon se Ai do ta humbasë, atëherë ai nuk ka mendim të mirë ndaj Allahut. Ibën Kajim, rahimehullah ka thënë: *“Shumica e njerëzve, madje të gjithë, përveç ata që i ka ruajtur Allahu, kanë mendim të keq për Atë, për arsye sepse mendojnë se meritojnë më shumë sesa që iu ka dhënë Allahu. Kush hulumton thellë në shpirtin e tij, do ta gjejë këtë të fshehur në të.”* Njeriu le të akuzojë veten e tij nëse nuk ka arritur ndonjë qëllim kur i është mbështetur Allahut, mangësia është te vetë ai, e jo tek Allahu.

kanë thënë: *"Mendimi i mirë për Allahun është mbështetja tek Ai."*
Pse njeriu i mbështetet Allahut? I mbështetet ngase ka mendim të mirë për Atë.

- Durimi ndaj caktimeve të Allahut. Mbështetja tek Ai përfshin durimin, sepse gjërat mund të mos ndodhin menjëherë ose mund të hasin në pengesa, dhe durimi pasqyron besimin në urtësinë e Allahut.
- Leximi i biografive të të Dërguarve, sepse ata janë të parët e atyre të cilët i janë mbështetur Allahut. Po ashtu, leximi i biografive të sahabëve dhe të besimtarëve të devotshëm.
- Dija rreth rezultateve të mira që sjell mbështetja tek Allahu.
- Kërkimi i ndihmës nga Allahu dhe lutja, duke i kërkuar Atij, të Plotfuqishmit, sukses dhe udhëzim në të gjitha çështjet dhe duke kërkuar falje për mëkatet që mund të jenë arsye për vonimin e arritjes së asaj që dëshiron. Edhe lutja tek Allahu është prej shkaqeve më të forta që duhet të ndër marrë njeriu që Ai t'ia largojë një fatkeqësi apo sprovë. Pikërisht në lutjen drejtuar Allahut ka mbështetje tek Ai. Kur njeriu i lutet Allahut, duke plotësuar kushtet dhe rregullat e lutjes dhe duke larguar pengesat për pranimin e saj, atëherë ai realisht i është mbështetur Atij, ngase ai e di se Allahu është Ai i Cili i përgjigjet kësaj lutjeje dhe e ndihmon.

Burimet:

-Ligjëratat nga seria “Kitabu Teubid”, me temën: “Mbështetja tek Allahu”

-Ligjëratat nga seria “Rijadu Salibin”, me temën: “Mbështetja tek Allahu”

-Ligjëratë e përgjithshme

Përmbajtja

Mbështetja tek Allahu – adhurim madhështor.....	3
a. Përkufizimi dhe realiteti i tewekulit.....	5
b. Kthimi i zemrës kah Allahu, e jo kah shkaqet.....	6
c. Tewekuli te dikush tjetër përveç Allahut.....	9
d. Kush i mbështetet Allahut, Ai do t'i mjaftojë atij.....	10
Argumentet që flasin për tewekulin.....	12
Ajeti kuranor: “Vetëm Allahut mbështetjuni!”.....	12
Hadithi: “O Allah, Vetëm tek Ti jam mbështetur!”.....	13
Ajeti kuranor: “Mbështetu në të Gjithëjeshmin”.....	15
Hadithi: “Jam mbështetur tek Allahu”.....	16
Ajeti kuranor: “vetëm te Zoti i tyre mbështeten”.....	19
Si arrihet mbështetja tek Allahu?.....	21
a. Veprimi i shkaqeve dhe përpjekja.....	22
b. Disa gjëra që ndihmojnë në forcimin e tewekulit.....	26